

Banka e Shqipërisë

ANALIZË E ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË T1 - 2019

Enian Çela

Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

KORRIK 2019

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P E R M B A J T J A

| | | |
|----|--|----|
| 1. | ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE | 5 |
| 2. | LLOGARIA KORRENTE | 6 |
| 3. | LLOGARIA KAPITALE | 9 |
| 4. | LLOGARIA FINANCIARE | 10 |
| 5. | PROFILI I FINANCIMIT TË DEFICITIT KORRENT | 12 |

1. ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE¹

Deficiti i llogarisë korrente u raportua në 243.3 milionë euro për tremujorin e parë të vitit 2019², duke u zgjeruar me rreth 41.4% në terma vjetorë. Ndikimi kryesor në zgjerimin e deficitit korrent ka buruar nga nënlllogaria e mallrave, me ndikime suplementare nga nënlllogaritë e të ardhurave parësore e dytësore. Deficiti korrent u vlerësua në nivelin 8.0% ndaj PBB-së nominale, ose 1.9 pikë përqindjeje më i lartë se i njëjti tremujor i një viti më parë. Vlerësohet që në këtë drejtim ka ndikuar zgjerimi i hendekut të kursime- investimeve në sektorin privat ndaj PBB-së, kryesisht si pasojë e pakësimit të kursimeve (shih hapësirën informuese për “Zhvillimet në hendekun e kursimeve dhe investimeve”).

Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve shënuan një rritje prej 5.2% në terma vjetorë. Kontributi lidhet tërësisht me dinamikën e eksportit të shërbimeve, i cili u zgjerua me 8.5% krahasuar me një vit më parë. Në këtë rast, ndikimet lidhen me kategorinë e “shërbimeve të përpunimit të inpueteve fizike” dhe “shërbimet e tjera”. Ndikime pozitive kanë ardhur edhe nga eksporti i “shërbimeve të udhëtimit”, i cili u rrit me 5.1% krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, eksporti i mallrave u zvogëluar me 4.0% në terma vjetorë, ndikuar më së shumti nga pakësimi i ndjeshëm i eksportit të energjisë elektrike.

Importet e mallrave dhe shërbimeve u zgjeruan me 7.4% në terma vjetorë. Kontributi kryesor buroi nga zgjerimi i importit të mallrave me rreth 8.5%. Rritja e shpejtë e importit të mallrave është e lidhur ngushtësisht me importin e energjisë elektrike për të kompensuar mungesën e prodhimit vendas. Paralelisht, raportohet një rritje e importit të shërbimeve me rreth 5.0% vit mbi vit. Kjo ecuri është ndikuar pothuaj tërësisht nga rritja e importit të “shërbimeve të udhëtimit”, fenomen i vënë re edhe gjatë vitit të kaluar. Si rrjedhojë e zhvillimeve në dy nënlllogaritë e tregtisë, deficiti i përgjithshëm tregtar në mallra dhe shërbime, u zgjerua me rreth 12.6% në terma vjetorë. Deficiti tregtar në mallra dhe ndikimin kryesor, duke u zgjeruar me 13.0%, ndërkohë që suficiti i shërbimeve ndikoi në kah të kundërt, pasi u zgjerua me rreth 13.5% krahasuar me një vit më parë.

¹ Të dhënat më të fundit të bilancit të pagesave i përkasin tremujorit të parë të vitit 2019. Duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2008, Banka e Shqipërisë harton Statistikat e Bilancit të Pagesave, në përputhje me standardet ndërkombëtare të parashikuara në Manualin e 6-të të Bilancit të Pagesave, publikuar nga FMN-ja. Ndryshimet kryesore mes metodologjisë aktuale dhe të mëparshme sintetizohet në udhëzuesin e mëposhtëm:

http://www.bankofalbania.org/web/pub/shpjegues_per_ndryshimet_ne_publicimin_e_statistikave_te_sektorit_te_jashtem_sipas_bpm6_qershor_2014_2_6688_1.pdf

Për efekt analizash, të dhënat e Bilancit të Pagesave, nga viti 2002 deri në vitin 2007, u riklasifikuan në përputhje me metodologjinë e re nga Departamenti i Politikës Monetare.

² Në fund të materialeve gjendet një tabelë përmbledhëse për zhvillimet kryesore të Bilancit të Pagesave gjatë periudhave të fundit, përfshirë tremujorin në analizë.

Suficiti i llogarisë së të ardhurave dytësore u ngushtua me 5.7% në terma vjetorë. Ndikimi kryesor buroi nga pakësimi në terma vjetorë i flukseve të të ardhurave hyrëse të "qeverisë së përgjithshme". Nga ana tjetër, u regjistrua një zgjerim i flukseve neto të remitançave me rreth 1.0% në terma vjetorë. Për sa i përket të ardhurave parësore, teprica negative u zgjerua me rreth 14.1 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Shkak për këtë zhvillim ka qenë zgjerimi i shpejtë i të ardhurave dalëse të lidhura me investimet direkte. Flukset hyrëse neto në llogarinë kapitale shënuan vlerën 17.5 milionë euro dhe rezultuan rreth 0.8 milionë euro më të ulëta kundrejt të njëjtit tremujor të një viti më parë.

Në llogarinë financiare, janë regjistruar detyrime neto në vlerën 359.3 milionë euro, rreth 24.2% më të larta krahasuar me një vit më parë. Ndikimi kryesor lidhet me një pakësim të fluksit dalës të mjeteve të rezidentëve kryesisht në formën e "monedhave dhe depozitave", të raportuar në nënlllogarinë e investimeve të tjera. Flukset hyrëse të investimeve direkte u zgjeruan me rreth 1.6% krahasuar me një vit më parë. Flukset neto hyrëse në llogaritë kapitale e financiare arritën të mbulojnë 154.9% të deficitit të llogarisë korrente, duke rezultuar në flukse dalëse për zërin "gabime dhe harresa". Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një pakësim të mjeteve të rezervës, me rreth 70.7 milionë euro. Stoku i rezervës valutore, në fund të tremujorit të parë të vitit 2019, është në gjendje të mbulojë 6.8 muaj import mallrash dhe shërbimesh ose 150% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto.


2. LLOGARIA KORRENTE

Deficiti i llogarisë korrente u raportua në 243.3 milionë euro në tremujorin e parë të vitit 2019, duke u zgjeruar me rreth 41.4% në terma vjetorë. Deficiti u vlerësua në nivelin 8.0% ndaj PBB-së nominale ose rreth 1.9 pikë përqindje më i lartë se i njëjti tremujor i një viti më parë. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2018, raporti është 2.8 pikë përqindje më i ulët.

Zgjerimi në terma vjetorë është përcaktuar tërësisht nga nënlllogaria e tregtisë së mallrave me ndikime nga të ardhurat parësore e dytësore. Deficiti tregtar në mallra u zgjerua me rreth 13.0% në terma vjetorë, ndikuar kryesisht nga rritja e importit të mallrave me 8.5%. Nga ana tjetër, eksportet e mallrave u pakësuan me rreth 4.0% gjatë së njëjtës periudhë, për shkak të efektit të energjisë elektrike.


Suficiti i nënlllogarisë së "shërbimeve" u zgjerua me 13.5% në terma vjetorë. Ndikimi kryesor buron nga rritja e eksportit të shërbimeve me 8.5%. Në këtë drejtim, ka ndikuar eksporti i "shërbimeve të përpunimit të inputeve fizike" dhe "shërbimet e tjera". Ndikime pozitive kanë buruar edhe nga eksportet e "shërbimeve të udhëtimit", të cilët raportuan një rritje vjetore prej 5.1%. Nga ana tjetër, rritja e importit të shërbimeve regjistroi 5.0%, ndikuar më së shumti nga rritja e importit të "shërbimeve të udhëtimit".

Grafik 1. Kontributi sipas kategorive (pikë përqindje) në ecurinë vjetore të deficitit korrent (%)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 2. Zërat kryesorë në llogarinë e shërbimeve (flukse neto në milionë euro)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bilanci neto i llogarisë së të ardhurave parësore rezultoi me një tepricë negative prej 28.9 milionë eurosh, ndërkohë që një vit më parë shënonte 14.8 milionë euro. Zgjerimi i tepricës negative, lidhet kryesisht me zgjerimin e fluksit të të ardhurave dalëse të investimeve direkte.

Suficiti i nënlllogarisë së të ardhurave dytësore, u ngushtua me rreth 11.6 milionë euro (ose 5.7%) në terma vjetorë. Ndikimi kryesor erdhi nga zvogëlimi i të ardhurave hyrëse të “qeverisë së përgjithshme” (rreth 15.1 milionë euro). Nga ana tjetër, prurjet neto të remitançave u rritën me rreth 1.0%.


Grafik 3. Bilanci i të ardhurave parësorë (flukse neto, në milionë euro, majtas) dhe të ardhurat nga investimet direkte (flukse neto, në milionë euro, djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Të ardhurat neto kumulative nga llogaria e shërbimeve, e të ardhurave parësore dhe atyre dytësore, financuan rreth 65.0% të deficitit tregtar të mallrave. Ky raport është 7.0 pikë përqindje më i ulët krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2018 dhe 8.7 pikë përqindje më i lartë krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Grafik 4. Dërgesat e emigrantëve (flukse neto, në milionë euro, majtas) dhe financimi i deficitit tregtar nga të ardhurat neto parësore, dytësore dhe nga shërbimet (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


HAPËSIRË INFORMUESE 1. ZHVILLIMET NË HENDEKUN E KURSIMEVE DHE INVESTIMEVE

Hendeku kursime-investime i sektorit privat u vlerësua në -8.9% të PBB-së nominale (vlera negative e hendekut nënkupton investime më të larta se kursimet) për tremujorin e parë të vitit 2019. Ky raport është 1.4 pikë përqindje më i lartë krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Raporti i investimeve private ndaj PBB-së nominale vlerësohet në nivelin 16.8%, ndërkohë që një vit më parë vlerësohej në 16.4%. Nga ana tjetër, kursimet private ndaj PBB-së nominale vlerësohen në nivelin 8.0%, rreth 0.9 pikë përqindje më të ulëta se një vit më parë. Në tërësi, dinamika e kursimeve ka dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e hendekut negativ në sektorin privat me kontribute suplementare nga investimet.

Në rastin e sektorit publik, është vënë re një hendek pozitiv (kursime më të larta se investimet) në nivelin 0.9% ndaj PBB-së nominale. Ndërkohë, një vit më parë, hendeku pozitiv vlerësohej në nivelin 1.4% ndaj PBB-së nominale. Si kursimet publike, ashtu edhe investimet janë pakësuar në raport me PBB-në nominale. Por ngadalësimi i kursimeve ka qenë më i shpejtë (nga 5.2% në 4.5%). Nga ana tjetër, raporti i investimeve publike ndaj PBB-së nominale është pakësuar nga 3.8% në 3.6%.

Në tërësi, raporti i investimeve kombëtare ndaj PBB-së është zgjeruar me 0.2 pikë përqindje. Nga ana tjetër, raporti i kursimeve kombëtare ndaj PBB-së nominale është pakësuar me 1.6 pikë përqindje. Zvogëlimi i raportit të kursimeve kombëtare ka qenë kështu përcaktues kryesor në zgjerimin e deficitit korrent në terma vjetorë.

Grafik 5. Kontributi i treguesve të investimeve dhe kursimeve në dinamikën e deficitit (majtas) dhe kontributi i tyre në ndryshimin vjetor të deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave.

3. LLOGARIA KAPITALE

Në tremujorin e parë të vitit 2019, teprica pozitive e llogarisë kapitale ishte rreth 17.5 milionë euro, rreth 0.8 milionë euro më e ulët krahasuar me një vit më parë. Flukset kapitale neto në këtë llogari vlerësohen në 0.6% ndaj PBB-së nominale. Transferrat kapitale neto për llogari të "qeverisë së përgjithshme" ishin teprice pozitive prej 4.1 milionë eurosh, ndërsa ato të "korporatave financiare dhe jofinanciare, ekonomive shtëpiake dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të ekonomive shtëpiake", ishin 13.2 milionë euro.


Kombinimi i transaksioneve neto të llogarisë korrente dhe asaj kapitale jep pozicionin neto të ekonomisë vendase si huadhënës neto (suficit) dhe huamarrës neto (deficit), kundrejt ekonomive jorezidente. Në terma sasiorë, për tremujorin e parë të vitit 2019, ekonomia jonë paraqet një pozicion neto huamarrës prej 225.8 milionë eurosh, i cili financohet nga llogaria financiare dhe zëri “gabime dhe harresa”. Ky nivel rezulton 46.8% më i lartë krahasuar me një vit më parë dhe 29.9% më i ulët krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

4. LLOGARIA FINANCIARE

Llogaria financiare regjistroi detyrime neto në vlerën 259.3 milionë euro për tremujorin e parë të vitit 2019, rreth 24.2% më të lartë krahasuar me një vit më parë. Detyrimet neto të kësaj llogarie u vlerësuan në rreth 11.7% të PBB-së nominale dhe financuan 147.7% të deficitit korrent të regjistruar gjatë kësaj periudhe.

Dinamika vjetore e fluksit neto është përcaktuar nga ecuria e mjeteve të nënlllogarisë së investimeve të tjera. Konkretisht, vihet re një pakësim i fluksit të mjeteve të rezidentëve në formën e “monedhave dhe depozitave” me rreth 145.2 milionë euro, krahasuar me një vit më parë. Këto mjete lidhen me sektorin e “korporatave depozitë-marrëse”.


Grafik 6. Llogaria financiare dhe gabime e harresa (flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Flukset hyrëse të Investimeve Direkte u zgjeruan me 1.6%. Flukset janë të përqendruara në sektorin e “energjisë” pasuar nga sektori i “hidrokarbureve”. Flukset totale hyrëse të investimeve direkte llogariten në rreth 9.3% të PBB-së nominale. Për tremujorin në analizë, fluksneto të investimeve direkte financuan rreth 114.9% të deficitit të regjistruar korrent. Ky raport ishte 55.0 pikë përqindje më i ulët se i njëjti tremujor i një viti më parë.

Grafik 7. Përbërësit e llogarisë financiare (flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8. Përbërja e investimeve direkte (flukse, në milionë euro, majtas) dhe raporti i financimit të deficitit korrent prej investimeve direkte neto (djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nënlllogaria e investimeve të portofolit, raporton për një tepricë neto hyrëse prej 0.1 milionë euro, ndërkohë që një vit më parë raportohej një tepricë neto e mjeteve në masën 3.5 milionë euro. Ndikimi kryesor lidhet me pakësimin e mjeteve të “korporatave depozitë-marrëse” si në formën e “kapitalit” ashtu edhe në formën e “detyrimeve të borxhit”. Nga ana tjetër, detyrimet janë pakësuar në trajtën e “borxhit”, por janë shtuar në formën e “kapitalit”. Në rastin e nënlllogarisë së investimeve të tjera, përveç zhvillimeve të mjeteve që u diskutuan më parë, raportohej një zgjerim i “detyrimeve të borxhit” dhe të “kredisë tregtare”.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një pakësim të mjeteve të rezervës në masën 70.7 milionë euro. Në fund të muajit mars 2019, stoku i rezervës valutore ishte rreth 3.4 miliardë euro. Ky nivel vlerësohet i mjaftueshëm

për mbulimin e 6.8 muajve import mallrash dhe shërbimesh ose 150% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto. Së fundi, llogaria “gabime dhe harresa neto”, rezultoi në një fluks dalës prej 133.5 milionë eurosh dhe u vlerësua në 4.4% ndaj PBB-së nominale.




5. PROFILI I FINANCIMIT TË DEFICITIT KORRENT

Qëndrueshmëria e financimit të deficitit korrent, përcaktohet nga ecuria e flukseve hyrëse borxh-krijuese, kundrejt flukseve hyrëse më të dëshirueshme jo-borxh-krijuese³. Kështu, flukset financiare jo-borxh-krijuese nga investimet direkte neto dhe nga llogaria kapitale u vlerësuan në nivelin 9.7% ndaj PBB-së nominale. Këto ishin rreth 1.3 pikë përqindje më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Flukset financiare borxh-krijuese u vlerësuan në nivelin 0.3% ndaj PBB-së nominale, rreth 5.5 pikë përqindje më të larta krahasuar me një vit më parë.

Pasi flukseve valutore neto borxh-krijuese dhe jo-borxh-krijuese në tërësi u shtohen edhe gabimet dhe harresat neto, përftohet masa e financimit të përgjithshëm të deficitit korrent. Gjatë tremujorit në analizë, raporti i financimit të llogarisë korrente ishte në nivelin 70.9%, duke u përkthyer në një pakësim të rezervës me 70.7 milionë euro. Ky raport rezulton rreth 53.7 pikë përqindje më i lartë krahasuar me një vit më parë, por 104.4 pikë përqindje më i ulët krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

³ Kjo ndarje shërben për të monitoruar ndikimin që flukset financiare e kapitale kanë në borxhin e jashtëm të vendit. Flukset jo-borxh-krijuese përfshijnë Investimet Direkte dhe hyrjet neto të llogarisë kapitale, ndërsa flukset borxh-krijuese përfshijnë investimet e portofolit dhe investimet e tjera neto.

Grafik 10. Flukset hyrëse financiare borxh-krijuese dhe jo-borxh-krijuese ndaj PBB-së nominale (majtas) dhe financimi në total i deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Tregues të bilancit të pagesave (të dhëna në milionë euro)

| | T3'17 | T4'17 | T1'18 | T2'18 | T3'18 | T4'18 | T1'19 |
|--|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Llogaria korrente (në mil euro) | -142.8 | -309.9 | -172.1 | -176.5 | -147.5 | -363.6 | -243.3 |
| vmv (%) | -3.9 | 74.5 | 9.3 | -31.0 | 3.3 | 17.3 | 41.4 |
| / PBB-së (%) | -4.9 | -10.2 | -6.1 | -5.2 | -4.6 | -10.8 | -8.0 |
| Mallra dhe shërbime | -373.8 | -570.2 | -360.1 | -429.0 | -361.4 | -616.4 | -405.6 |
| vmv (%) | -9.0 | 30.5 | 15.5 | -11.8 | -3.3 | 8.1 | 12.6 |
| Eksporte, f.o.b. | 1110.0 | 875.6 | 840.0 | 1022.1 | 1238.7 | 951.1 | 883.8 |
| vmv (%) | 19.8 | 2.2 | 8.6 | 14.3 | 11.6 | 8.6 | 5.2 |
| Importe, f.o.b. | 1483.8 | 1445.8 | 1200.1 | 1451.2 | 1600.0 | 1567.6 | 1289.4 |
| vmv (%) | 10.9 | 11.7 | 10.6 | 5.1 | 7.8 | 8.4 | 7.4 |
| Udhëtime neto | 180.9 | 109.6 | 77.6 | 83.5 | 197.1 | 72.1 | 75.9 |
| Të ardhura parësore | 18.8 | 7.1 | -14.8 | 13.7 | -18.9 | 14.6 | -28.9 |
| Kredi | 106.6 | 98.4 | 72.1 | 125.4 | 95.7 | 104.9 | 80.2 |
| Debi | 87.8 | 91.2 | 86.8 | 111.7 | 114.6 | 90.3 | 109.1 |
| Të ardhura neto nga Investimet Direkte | -50.6 | -46.4 | -63.1 | -89.1 | -87.5 | -41.3 | -72.4 |
| Të ardhura dytësore | 212.2 | 253.1 | 202.8 | 238.9 | 232.8 | 238.3 | 191.2 |
| Kredi | 236.7 | 284.7 | 224.4 | 260.5 | 253.9 | 264.1 | 219.2 |
| Debi | 24.5 | 31.6 | 21.6 | 21.6 | 21.2 | 25.8 | 28.0 |
| Dërgesa nga emigrantët -neto | 165.8 | 172.1 | 148.6 | 181.7 | 170.0 | 169.2 | 150.2 |
| vmv (%) | 3.9 | 4.1 | 10.0 | 11.7 | 2.6 | -1.7 | 1.0 |
| Llogaria kapitale | 30.4 | 42.9 | 18.3 | 21.2 | 22.9 | 41.6 | 17.5 |
| Huamarrije neto/Huadhënie neto | -112.3 | -267.1 | -153.8 | -155.2 | -124.6 | -322.0 | -225.8 |
| Llogaria financiare | -222.3 | -205.4 | -289.3 | -200.1 | -17.1 | -267.3 | -359.3 |
| vmv (%) | 144.2 | 72.0 | -2.2 | -3.0 | -92.3 | 30.2 | 24.2 |
| / PBB-së (%) | -7.7 | -6.8 | -10.3 | -5.9 | -0.5 | -7.9 | -11.7 |
| Investime direkte | -340.2 | -221.3 | -292.4 | -222.6 | -268.9 | -242.1 | -279.4 |
| vmv (%) | 12.5 | -13.8 | 41.6 | -1.5 | -20.9 | 9.4 | -4.4 |
| Investime portofoli | 31.2 | 27.9 | 3.5 | 110.6 | 13.1 | -202.3 | -0.1 |
| Derivativë financiarë | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 |
| Investime të tjera | 49.1 | -227.3 | 142.0 | -173.3 | 83.9 | -96.8 | -9.1 |
| Mjetet e rezervës | 37.6 | 215.4 | -142.4 | 85.1 | 154.8 | 273.9 | -70.7 |
| Gabime dhe harresa | -110.0 | 61.7 | -135.5 | -44.9 | 107.5 | 54.7 | -133.5 |

